



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

Numri i lëndës: 2021:048297

Datë: 13.11.2024

Numri i dokumentit: 06449383

C.nr. 455/20

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – DEGA NË SUHAREKË, me gjyqtarin Robert Tunaj dhe pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Leonit Çoçaj, në çështjen juridike civile të paditësve N.F,R dhe B.K, që të gjithë nga S, të cilët me autorizim i përfaqëson avokat N. B nga S, kundër të paditurit Komuan e Suharekës, të cilin me autorizim i përfaqëson avokat publik komunal A. B , me objekt kontesti – vërtetim i të drejtës së shfrytëzimit të përhershëm , pas mbajtjes së seancës kryesore të datës 05.12.2024, ,gjykata me datën 24.12.2024 mori dhe përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I.REFUZOHET në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditësve – të kundër paditurve M. G, I. G dhe S. G, me të cilën kanë kërkuar që të “*DETYROHEN të paditurit – kundër paditësit E. K dhe F. K, të bëjnë lirim-in-dorëzimin e pjesës së ngastrës me numër P-72116046-00349-1, me sipërfaqe prej S=182 m², e cila gjendet në anën perëndimore të parcelës, në gjerësi dhe gjatësi si vijon: duke filluar nga pika numër 2, me gjatësi prej 33.6m deri te pika 20, vazhdon me gjatësi 18.6m deri te pika 21, vazhdon me gjatësi 19.3m deri te pika 22, vazhdon me gjatësi 28.9m deri te pika 23, vazhdon me gjatësi 9.5m deri te pika 24, vazhdon me gjatësi 9.4m deri te pika 25, vazhdon me gjatësi 7.3m deri te pika 26, vazhdon me gjatësi 4.3m deri te pika 5, vazhdon me gjatësi 25.6 deri te pika 4, vazhdon me gjatësi 63.6m deri te pika 3 dhe përfundon me gjatësi 35.2m te pika e fillimit numër 2*”.

II.APROVOHET si e bazuar kërkesa nga kundërpadia e të paditurve – kundër paditësve E. K dhe F. K, ashtu që **VËRTETOHET** se të paditurit – kundër paditësit janë pronarë në bazë të mbajtjes me mirëbesim – parashkrimit fitues të pjesës së parcelës së ngastrës kadastrale me

numër P-72116046-00349-1, me shfrytëzim aktual arë e klasës 4, në vendin e quajtur Pallanka, ZK Suharekë, me sipërfaqe prej S=182 m², e cila gjendet në anën perëndimore të parcelës, në gjerësi dhe gjatësi si vijon: duke filluar nga pika numër 2, me gjatësi prej 33.6m deri te pika 20, vazhdon me gjatësi 18.6m deri te pika 21, vazhdon me gjatësi 19.3m deri te pika 22, vazhdon me gjatësi 28.9m deri te pika 23, vazhdon me gjatësi 9.5m deri te pika 24, vazhdon me gjatësi 9.4m deri te pika 25, vazhdon me gjatësi 7.3m deri te pika 26, vazhdon me gjatësi 4.3m deri te pika 5, vazhdon me gjatësi 25.6 deri te pika 4, vazhdon me gjatësi 63.6m deri te pika 3 dhe përfundon me gjatësi 35.2m te pika e fillimit numër 2.

III.DETYROHEN paditësit - të kundër paditurit M. G, I. G dhe S. G, që të paditurve – kundër paditësve E. K dhe F. K, ti njohin të drejtën e pronësisë në sipërfaqe të përcaktuar në pikën II të këtij Aktgjykimi.

IV.DETYROHEN paditësit - të kundër paditurit M. G, I. G dhe S. G, që në emër të shpenzimeve procedurale, në mënyrë solidarë t'ia paguajnë të paditurve – kundër paditësve shumën prej 1058.00 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditë nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Paditësit - kundër paditësit M. G, I. G dhe S. G, që të gjithë nga S, pranë kësaj gjykate, përmes të autorizuarës së tyre, avokat N. H nga S, me datë 16.03.2021, kanë parashtruar padinë me së cilës kanë kërkuar që të vërtetohet se i padituri – kundër paditësi E. K, mbanë në shfrytëzim dhe posedim të kundërligjshëm sipërfaqen prej 0.04.00 ha, të marrë nga ngastra me numër P-72116046-00349-1, me shfrytëzim aktual arë e klasës 4, në vendin e quajtur Pallanka, në sipërfaqe prej 1188 m², në rrugën Migjeni, ZK Suharekë, në emër të pronarëve M. G me 2/4, I. G me ¼ dhe S. G me ¼, duke kërkuar që të obligohet i njëjti të bëjë dorëzimin e paluajtshmërisë dhe vërtetimin e mbajtjes, shfrytëzimit dhe posedimit të kundërligjshëm.

I padituri – kundër paditësi Elez Kuqi, pranë kësaj gjykate me datë 22.08.2024, ka parashtruar kundërpadinë, përmes të autorizuarit të tij avokat S. H nga S, kundrejt këtu paditësve – të kundër paditurve M. G, I. G dhe S. G, me të cilën ka kërkuar që të vërtetohet se në bazë të mbajtjes është pronar i një pjese të parcele me numër P-72116046-00349-1, me shfrytëzim aktual arë e klasës 4, në vendin e quajtur Pallanka, ZK Suharekë, me sipërfaqe prej S=182 m², e cila gjendet në anën perëndimore të parcelës, në gjërsi dhe gjatësi si vijon: duke filluar nga pika numër 2, me

gjatësi prej 33.6m deri te pika 20, vazhdon me gjatësi 18.6m deri te pika 21, vazhdon me gjatësi 19.3m deri te pika 22, vazhdon me gjatësi 28.9m deri te pika 23, vazhdon me gjatësi 9.5m deri te pika 24, vazhdon me gjatësi 9.4m deri te pika 25, vazhdon me gjatësi 7.3m deri te pika 26, vazhdon me gjatësi 4.3m deri te pika 5, vazhdon me gjatësi 25.6 deri te pika 4, vazhdon me gjatësi 63.6m deri te pika 3 dhe përfundon me gjatësi 35.2m te pika e fillimit numër 2. ,duke kërkuar që të detyrohen paditësit – të kundër paditurit që t’ia njohin të drejtën e pronësisë dhe e njëjta të regjistrohet në pronësi të të paditurit – kundër paditësit pranë Zyrës Kadastrale në Suharekë.

Me datë 24.10.2024 është caktuar dhe mbajtur seanca gjyqësore, në të cilën seancë i autorizuari i të paditurit – kundër paditësit ka bërë zgjerimin e padisë në kuptimin subjektiv, ku palë kundër paditëse ka cekur edhe F. K, për të cilën propozim gjykata e ka aprovuar.

E autorizuar e paditësve – të kundër paditurve në fjalën përfundimtare të paraqitur me shkrim pranë kësaj gjykate me datë 30.10.2024 ka precizuar kërkesëpadinë duke kërkuar që të detyrohen të paditurit – kundër paditësit E. K dhe F. K, të bëjnë lirimin-dorëzimin e pjesës së ngastrës me numër P-72116046-00349-1, me sipërfaqe prej S=182 m², e cila gjendet në anën perëndimore të parcelës, në gjerësi dhe gjatësi si vijon: duke filluar nga pika numër 2, me gjatësi prej 33.6m deri te pika 20, vazhdon me gjatësi 18.6m deri te pika 21, vazhdon me gjatësi 19.3m deri te pika 22, vazhdon me gjatësi 28.9m deri te pika 23, vazhdon me gjatësi 9.5m deri te pika 24, vazhdon me gjatësi 9.4m deri te pika 25, vazhdon me gjatësi 7.3m deri te pika 26, vazhdon me gjatësi 4.3m deri te pika 5, vazhdon me gjatësi 25.6 deri te pika 4, vazhdon me gjatësi 63.6m deri te pika 3 dhe përfundon me gjatësi 35.2m te pika e fillimit numër 2. Ka shtuar se përgjatë shqyrtimit kryesor është vërtetuar se ekziston baza juridike e kërkesëpadisë për lirimin dhe dorëzimin e paluajtshmërisë, pasi që paditësit – të kundër paditurit janë pronarë juridik të ngastrës kadastrale kontestuese, duke u vërtetuar në bazë të certifikatës mbi të drejtën pronësore, duke shtuar se pronarë të kësaj ngastre janë që nga viti 1950, në bazë të trashëgimisë, ndërsa të paditurit më vonë e kanë blerë ngastrën kadastrale e cila është në mexhë me ngastrën kadastrale kontestuese, duke shtuar se i padituri – kundër paditësi E. K, në mënyrë të kundërligjshme është duke e shfrytëzuar pjesën e parcelës 349-1, në sipërfaqe prej 182 m², që është në bashkëpronësi të paditësve – kundër paditurve, duke i mbjellë të njëjtit hardhitë e rrushit. Ka shtuar se të paditurit – kundër paditësit me asnjë provë të vetme nuk kanë mundur të vërtetojnë faktin se në posedim të ngastrës kadastrale kanë hyrë në bazë të punës juridike ose veprimi juridik, asnjëherë nuk kanë iniciuar ndonjë procedurë gjyqësore për të vërtetuar pronësinë e kësaj pjese të

paluajtshmërie. Gjithashtu, ka theksuar se paditësit – të kundër paditurit kanë deklaruar se është e vërtetë se ngastra kadastrale, objekt kontesti dhe prona e paditësve në mexhë me këtë parcelë është mbjellë me vreshta në vitin 1980, ndërsa diku para 10-15 viteve kanë mbjellë grurë. Ku rreth vitit 2020 është ndarë mes vëllezërve, ku është marrë kadastri dhe është vendosur mexha dhe është vërtetuar fakti se të paditurit – kundër paditësit në mënyrë të kundërligjshme janë duke e shfrytëzuar pjesën e ngastrës kadastrale objekt kontesti, duke kërkuar kështu nga të njëjtit lirim e pronës përmes B. K dhe Sh. K (djem të agjës së palëve ndërgjyqjese) në procesin kontestimor të dëgjuar si dëshmitarë, si dhe vendosjen e mexhës sipas kufijve që janë në pronësi të tyre, por të paditurit – kundër paditësit nuk kanë pranuar, duke pretenduar se e njëjta është në shfrytëzim të tyre dhe nuk kanë marrëveshje dhe nuk duan të kenë lidhur me këtë. Sa i përket prezumimit për fitimin juridikisht të vlefshëm të së drejtës së pronësisë mbi bazën e parashkrimit fitues të pjesës së ngastrës kadastrale objekt kontesti, pa ekzistuar ndonjë bazë tjetër e vlefshme juridike, qoftë trashëgimisë, kjo pasuri qysh në vitin 1950 është e regjistruar në emër të paraardhësve të paditësve dhe nga ajo kohë të njëjtit nuk kanë provuar të ketë ndarje tjetër, veprim juridik si shitblerje apo marrëveshje tjetër që mund të vërtetonte mirëbesimin, pasi që në rastin konkret mirëbesimi vetëm mund të supozohet dhe duhet të provohet ky fakt. Sa i përket mirëbesimit, ka shtuar se fakti se të paditurit janë në posedim të pjesës së parcelës objekt kërkesëpadsisë nuk do të thotë se mund të fitojnë pronësinë mbi bazën e posedimit, pasi që në bazë të gjitha provave të administruara është vërtetuar fakti se të paditurit – kundër paditësit e kanë posedimin me keqbesim sepse vazhdimisht kanë pasur njohuri se pjesa e parcelës dhe parcela në tërësi evidentohet në emër të paditësve dhe asnjëherë nuk kanë iniciuar procedurë gjyqësore për vërtetim pronësie. Ka kërkuar shpenzimet gjyqësore të specifikuara për përpilimin e padisë 208 € ,përfaqsim në tri seanca të mbajtur nga 270,40€,një të pa mbajtur 135,20€ ekspertizë 200€ dhe taksa gjyqësore 21€ e në total kanë kërkuar shumën prej 1,375.40 euro.

I autorizuari i të paditurve – kundër paditësve në fjalën përfundimtare të paraqitur me shkrim me datë 01.11.2024 pranë kësaj gjykate ka theksuar se është vërtetuar fakti se ekziston baza juridike e kundërpadsisë lidhur me vërtetimin e pronësisë mbi ngastrën kadastrale objekt kontesti, ashtu që, ky fakt u vërtetua nga ekspertiza e ekspertit gjeodet, sipas së cilës ekspertize të paditurit – kundër paditësit kanë ndërhyrë në pjesën e parcelës me numër 349-1, me sipërfaqe prej 182 m2, duke u vërtetuar ky fakt edhe nga provat materiale dhe personale, konkretisht nga deklarata e dëshmitarëve B. K, A. K dhe S. K , u vërtetua fakti se të paditurit e kanë ushtruar pushtetin faktik nga viti 1980, ku kjo parcelë është mbjellë me vresht, janë vendosur shtylla betoni dhe në këta kufijtë faktik është shfrytëzuar dhe shfrytëzohet edhe sot dhe asnjëherë të vetme nuk është

kontestuar nga palët paditëse deri në momentin e paraqitjes së padisë. Gjithashtu edhe vet paditësit – të kundër paditurit e kanë vërtetuar këtë fakt me deklaratat e tyre. Lidhur me këtë, edhe i padituri – kundër paditësi E. K në cilësi të palës me deklaratën e tij e vërtetoi faktin se i njëjti pjesën e parcelës objekt kontesti e shfrytëzon me mirëbesim nga viti 1980 kur është mbjellë me vresht dhe nuk ka pasur asnjë kundërshtim nga palët paditëse – kundër paditura, deri në momentin e ngritjes së padisë. Andaj, nga këto është vërtetuar se ekziston baza ligjore për fitimin e pronësisë mbi bazën e mbajtjes, bazuar në nenin 20 të LTHMJ-së, ngase janë plotësuar kushtet që parasheh kjo dispozitë, pasi që i padituri me mirëbesim dhe posedim të pandërprerë mbi 20 vite e ka ushtruar pushtetin faktik mbi pjesën e parcelës, dhe paditësit asnjëherë nuk e kanë kundërshtuar dhe ka kërkuar të aprovon kundërpadinë e të paditurve – kundër paditësve si të bazuar duke i detyruar paditësit – të kundër paditurit t’ia njohin të drejtën e pronësisë në pjesën e parcelës objekt kontesti, si në pikat gjeodezike të përcaktuara në ekspertizë dhe të lejohet të bëhet regjistrimi në regjistrat e kadastrit në emrin e të paditurve. Shpenzimet gjyqësore i ka kërkuar të specifikuar për përpilimin e kundër padisë 208 € ,përfaqësim në tri seanca të mbajtur nga 270€ € dhe taksa gjyqësore 40€ e në total kanë kërkuar shumën prej në shumën prej 1,058.00 euro.

Për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike kontestimore, gjykata ka bërë administrimin e këtyre provave:

- Ka dëgjuar në cilësi të palës paditësit-kundërpaditurit M,I dhe S. G dhe të paditurin/kundërpaditësin E. K,
- Ka dëgjuar dëshmitaret B.t K, S. K dhe A. K ,
- Certifikata e pronës me numër 1262/2021, e datës 05.03.2021;
- Skica e terrenit e datës 05.03.2021;
- Certifikata e pronës me numër 2796/2024, e datës 21.08.2024;
- Ekspertiza e ekspertit gjeodet A. F, e datës 30.09.2024.

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave se bashku, çmuarjes me kujdes e ndërgjegje të secilës provë e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 8 të LPK-së, konstatoi se:

Kërkesëpadia e paditësve – të kundër paditurve **është në tërësi si e pa bazuar**, ndërsa, Kundërpadia e të paditurve – kundër paditësve **është në tërësi e bazuar**.

I dëgjuar në cilësi të palës , paditësi – i kundër padituri M. G, në seancën gjyqësore të datës 24.10.2024 ku ka theksuar se ngastrën e cila është objekt kontesti është bashkëpronar i të njëjtës qysh para 60 viteve, trashëguar nga babai i tij, ku deri në vitin 2012 gjysma e saj ka qenë e mbjellë me vresht, ndërsa gjysma tjetër ka qenë me vresht deri më 2020, ndërsa tash është e mbjellë me grurë. Ngastër kufizohet me të paditurin E në njërën anë, ndërsa në anën tjetër me A. K. Sa i përket ngastrës së të paditurve - kundër paditësve E. K dhe F. K, kjo ngastër është e mbjellë me vresht, ndërsa mexha me këtë ngastër nuk ka qenë e vendosur por kur është lëvruar aty ka qenë një pemë në mexhë të cilën e ka larguar vëllai i tij kur është mbjellë vreshti në vitin 1980. Ka theksuar se e ka punuar një pjesë të parcelës së të paditurve për aq sa edhe të paditurit kanë hyrë në pronën e tij, ku këtë fakt e ka kuptuar nga Ai, i cili i kishte thënë se në momentin e nxjerrjes së vreshtave do ta marrin katastrin dhe do ti identifikojmë vreshtat, ku pas marrjes së kadastrës është gjetur mexha nga ka rezultuar se edhe ara e tyre është mangu. Me të kuptuar se ara e tij është më e vogël ka shkuar te B. K së bashku me vëllezërit e tij, para 3-4 viteve, duke i treguar se e ka marrë katastrin privat dhe ka dal se ara e tij futet në pronën e E. dhe F, por duke mos gjetur mirëkuptim, andaj i është drejtuar gjykatës. Ka shtuar se deri te ndryshimi i pikave ka ardhur nga viti 1979 – 1980 kur të paditurit e kanë lëvruar një pjesë të rrugës dhe atëherë e kanë zhvendosur pikën përderisa ata nuk kanë qenë prezent. Sipas tij, i padituri E i ka thënë se ku e vendos kadastri aty ka me qenë mexha. Në pyetjet drejtuar nga i autorizuari i të paditurve – kundër paditësve, paditësi M, ka theksuar se në pjesën e parcelës të cilën kanë ndërhyrë të paditurit, kush e ka shfrytëzuar këtë pjese, ka theksuar se të njëjtën e kanë shfrytëzuar të paditurit, por nuk e ka ditur këtë fakt deri sa e kanë marrë kadastrin.

I dëgjuar në cilësi të palës paditësi – i kundër padituri I. G, në seancën gjyqësore të datës 24.10.2024 ku ka theksuar se pronën objekt kontesti e ka trashëguar nga babai – gjyshi, ndërsa familja K, pronën e tyre e kanë blerë pas atyre diku para 60 vitesh, ku në këtë kohë kanë qenë mexhat e vendosura, kjo parcelë deri në vitin 1980 ka qenë lavërtarë ndërsa atë vit është mbjellë me vresht, deri diku para 14-15 vitesh kur është hekur vreshti. Në momentin e mbjelljes së vreshtave ajo është mbjellë në bazë të mexhave të cilat kanë qenë atëherë, ku kur e ka mbjellë vreshtën agja i të paditurve Sh, i ka ftuar duke i thënë se me rastin e mbjelljes së vreshtit po largohet nga mexha për gjysmë metër, ndërsa të njëjtën të veprojnë edhe paditësit, e ashtu është vepruar. Sa i përket faktit se kur është informuar lidhur me shfrytëzimin e pjesës së parcelës objekt kontesti nga të paditurit, të cilën pjesë e shfrytëzojnë nga viti 1980 kur janë mbjellë vreshtat, ka theksuar se këtë fakt e ka kuptuar diku para 4 vitesh, ku megja e paditësve po del në

pronën e tyre sipas kadastrit, por të paditurit nuk e kanë pranuar këtë fakt, duke provuar të rregullohet kjo çështje përmes njerëzve të ndryshëm por ata nuk kanë pranuar.

I dëgjuar në cilësi të palës paditësi – i kundër padituri S. G, në seancën gjyqësore të datës 24.10.2024 ku ka theksuar se pronar i tokës është ndër breza, ku kjo pronë ka qenë lavërtarë ndërsa në vitin 1980 është mbjellë me vreshta, lëvruar nga progresi, e cila ka qëndruar vresht deri para 10 – 15 vitesh. Sa i përket njohurisë se kur e ka kuptuar se të paditurit po e shfrytëzojnë arën e tij e ka kuptuar diku rreth vitit 2018 – 2019, ku pas kësaj ka shkuar te i padituri E, duke e njoftuar se sipas kadastrit ai ka hyrë në pronën e tij, por i njëjti ka thënë se do të marrë kadastrë tjetër dhe sido që të vendos kadastrë tjetër ashtu do ta lë. Këtë pjesë të parcelës objekt kontesti e ka shfrytëzuar dhe punuar i padituri E, që nga koha kur është mbjellur vresht. Kjo parcelë ka pasur mexhë edhe para se të mbjellët vreshti.

I padituri – kundër paditësi E. K, në seancën gjyqësore të datës 24.10.2024 ka theksuar se parcela objekt kontesti e cila evidentohet në emër të familjes G, është e mbjellë me grurë, ndërsa ngastra e tij në kufi është e mbjellë me vresht. Kjo parcelë sipas tij është e mbjellë me vresht që nga viti 1978 nga të kuptuarit nga familja, pasi që i njëjti ka lindur me 1978. Këtë parcelë ka shtuar se e punon ende, në kufijtë faktikë që janë edhe sot, ku e ka kuptuar edhe nga axha i tij se edhe para vreshtës e ka punuar në ata kufinjë. Lidhur me të kuptuarit se kur keni ndërhyrë në parcelën e familjes G, ka shtuar se është njoftuar në vitin 2021, kur e kanë marrë kadastrin dhe po luajnë mexhat, ku asnjëherë nuk e ka ditur se po e shfrytëzon një pjesë të parcelës që nuk ka qenë e tij. Sipas tij, familja G, kanë qenë tek ai për të rregulluar këtë çështje, por nuk kanë arritur deri në ndonjë marrëveshje, pasi që ka shtuar se nuk ka pasuri për të falë, e njëjta është e shenjtë dhe ashtu ja ka lënë babai.

Në seancën gjyqësore të datës 24.10.2024, dëshmitari B. K, ka theksuar se me të paditurin është në raport familjar, konkretisht djalë të axhës, ndërsa me paditësit fqinjë në bazë të ligjit. I njëjti ka shtuar se në kufi me parcelën objekt kontesti e ka parcelën e tij me sipërfaqe prej 1 hektar e 7 ari, ku parcela e paditësve ka qenë e mbjellë me vresht, ndërsa tani është kulturë lavërtarë e mbjellë, ndërsa prona e të paditurve – kundër paditësve ka qenë vresht e mbjellë nga viti 1980, e mbjellë nga vet ai sa ishte në shkollë të mesme, ku edhe në atë kohë ishin vendosur shtyllat e betonit, ku kishte qenë edhe vet prezent, pasi që ka qenë më parë pronë e agjës së tij, ku kjo pronë gjithmonë është përdorur dhe punuar në kufijtë faktik, ka pasur ndarje fizike mes pronave, ku është punuar nga të paditurit – kundër paditësit, pa ndërprerë nga ajo kohë, ku agja i tij

asnjëherë nuk ka pasur ndonjë ankesë nga fqinjët, konkretisht nga familja G. Lidhur me mosmarrëveshjet mes familjeve të palëve ndërgjyqjese, ka shtuar se para se të iniciohet kjo procedurë, familja G, ka qenë në shtëpinë e tij dhe kanë kërkuar që të zgjidhet kjo çështje të zgjidhet jashtë procedurës gjyqësore, ku me këtë rast ka qenë te familja K, për ti tregu për shqetësimet e familjes G, por të njëjtit nuk janë pajtuar lidhur me këtë, duke shtuar se nuk kanë ndërhyrë në pronën e paditësve.

Në seancën gjyqësore të datës 24.10.2024, dëshmitari A. K, ka theksuar se prona e tij kufizohet me të paditurin E, ku prona e tij është e mbjellë me vresht, e cila ka qenë e mbjellë me vresht nga viti 1980 apo 1981, ku të njëjtit këtë parcelë e kanë shfrytëzuar në vazhdimësi në këta kufi, ndërsa vet ai ka theksuar se nuk e ka punuar asnjëherë këtë parcelë, ndërsa prona e paditësve është e mbjellë me grurë, por më parë ka qenë e mbjellë edhe kjo si vresht, deri pas lufte ku më pas është hequr vreshti. Sa i përket mosmarrëveshjeve mes palëve ndërgjyqjese ka shtuar se është informuar para 2 vitesh. Axha i tij ka vdekur në janar të vitit 2004, ndërsa ka shtuar se si ngastra e axhës ashtu edhe e tij ka qenë e mbjellë njëkohësisht me vresht, por duke theksuar se nuk e di nëse ka qenë në tërësi e mbjellë ose jo.

Me provat personale ,dëgjimin e palëve në procedurë dhe dëshmitareve të dëgjuar në seancë gjykata me pa mëdyshje ka vërtetuar gjendjen faktike si vijon: Ngastra objekt kontesti është e regjistruar në librat katastral në emër të paditësve/kundër paditurve por në teren një pjesë e ngastrës 349-1 në sipërfaqe 182 m2 shfrytëzohet në mënyrë të qetë dhe të pa penguar nga askush nga të paditurit / kundër paditësit që nga viti 1980. Paditësit / kundër paditurit secili veq e veq duke përshkruar historiatin e kësaj ngastre kanë provuar faktin se ngastra objekt kontesti që në vitin 1980 është mbjellë vresht, sikurse edhe ngastra fqinje e të paditurve / kundër paditësve me nr.348-100. Se ngastra e të paditurit / kundër paditësit 348-100 edhe sot është e mbjellë vresht , ndërsa ngastra e paditësve / kundre paditurve është arë (grurë). Se deri në vitin 2020 kur e kanë marr katastrin paditësit /kundër paditurit nuk kanë pas asnjë mos marrëveshje me të paditurit/kundër paditësit ,dhe deri në atë kohë nuk ka pasuar asnjë kundërshtim rreth pjesës së ngastrës 349-1 që tani shfrytëzohet nga të paditurit/ kundër paditësit. Kontesti ka lindur vetëm pas vitit 2020 për qka edhe palët fillimisht sipas traditës me dëshmitaret e dëgjuar kanë kërkuar ndërmjetësim e më pas me padi i janë drejtuar gjykatës në vitin 2021.

Faktin se i padituri ngastrën e mbanë me mirë besim nga viti 1980 e ka provuar edhe me dëgjimin e të paditurit E. K, i cili ka dëshmuar se nga viti 1980 ngastra objekt kontesti është mbjellë vresht

nga paditësit ashtu sikurse edhe ngastra e tij në fqinjësi dhe atë në kufi që kanë qenë edhe atëherë edhe sot të vendosur. Edhe sot ngastra e tij është vresht bashkë me pjesën që pretendon pronësinë, ndërsa ngastra e paditësve është e mbjell me grurë. Asnjëherë nuk është penguar në shfrytëzimin e pjesës kontestuese deri në vitin 2020 kur linden kërkesat e paditësve.

Edhe me dëshmitaret e dëgjuar është provuar fakti se të paditurit / kundër paditësit kanë qenë në shfrytëzim të qetë dhe të pa penguar të ngastrës 348-100 pronë e tyre por edhe pjesë së ngastrës 349-1 që më vonë ka rezultuar se është e regjistruar në emër të paditësve/ kundër paditurve . Me këta dëshmitar është vërtetuar fakti se të paditurit/ kundër paditësit , pjesën e ngastrës objekt kontesti 349-1 e kanë shfrytëzuar në vazhdimësi ,por në veqanti kanë provuar se nga viti 1980 kur edhe është mbjellë vresht janë në posedim të qetë dhe të pa penguar nga askush e as nga paditësit/kundër paditurit. Konteste ka lindur para tre vitesh kur edhe është kërkuar ndërmjetësimi prej tyre nga pala paditëse.

Deklaratat e palëve në procedurë edhe dëshmitarëve të dëgjuar janë në harmoni të plotë në mes vete si të tilla bindëse për gjykatën. Për me tepër këto deklarata përputhen edhe me të gjeturat dhe konstatimet e ekspertit gjeodet me gjykatën në vend ngjarje , ku konstatohet se ngastra objekt kontesti 349-1 pjesërisht në sipërfaqe 182 m2 në teren shfrytëzohet nga të paditurit / kundër paditësit me kulturë vresht. Se në mes ngastrës 349-1 dhe 348-100 ekziston mexhë , prej kohësh, se pjesa e ngastrës kontestuese është vresht e vjetër gjë që provohet edhe me fotot e terrenit dhe ortofotot e kastarit të bashkangjitura ekspertizës gjeodete.

Në bazë të Certifikatës së pronës me numër 1262/2021, e datës 05.03.2021, shihet se ngastra kadastrale me numër P-72116046-00349-1, është në sipërfaqe të përgjithshme prej 1188 m2, e cila gjendet në vendin e quajtur Pallanka, si tokë bujqësore, arë e klasës 4, e cila gjendet në bashkë posedim të palëve paditëse – të kundër paditura, konkretisht M. G, I. G dhe S. G.

Në bazë të skicës së terrenit të datës 05.03.2021, është e paraqitur njësia kadastrale – parcela me numër P-72116046-00349-1, me sipërfaqe prej 1188 m2.

Në bazë të Certifikatës së pronës me numër 2796/2024, e datës 21.08.2024, shihet se ngastra kadastrale me numër P-72116046-00348-100, është në sipërfaqe të përgjithshme prej 3394 m2, e cila gjendet në vendin e quajtur Pallanka, në njësinë kadastrale në Suharekë, e cila pronë

shfrytëzohet si tokë bujqësore, arë e klasës 4, në bashkë posedim me ½ nga të paditurit – kundër paditësit E. K dhe F. K.

Në bazë të ekspertizës së ekspertit gjeodet A. F, e datës 30.09.2024, për parcelën me numër 349-1, shihet se një pjesë të kësaj parcele, në sipërfaqe prej S=182 m², e shfrytëzojnë të paditurit/kundër paditësit E dhe F K dhe atë në anën perëndimore të parcelës, duke filluar nga pika numër 2, me gjatësi prej 33.6m deri te pika 20, vazhdon me gjatësi 18.6m deri te pika 21, vazhdon me gjatësi 19.3m deri te pika 22, vazhdon me gjatësi 28.9m deri te pika 23, vazhdon me gjatësi 9.5m deri te pika 24, vazhdon me gjatësi 9.4m deri te pika 25, vazhdon me gjatësi 7.3m deri te pika 26, vazhdon me gjatësi 4.3m deri te pika 5, vazhdon me gjatësi 25.6 deri te pika 4, vazhdon me gjatësi 63.6m deri te pika 3 dhe përfundon me gjatësi 35.2m deri te pika e fillimit numër 2. Paditësit – të kundër paditurit M, I dhe S. G, e shfrytëzojnë pjesën e parcelës me numër 349-1, me sipërfaqe prej S=1006 m², e cila gjendet në anën lindore të parcelës dhe fillon nga pika numër 2 me gjatësi 33.6m, deri te pika 20, vazhdon me gjatësi 18.6m deri te pika 21, vazhdon me gjatësi 19.3m deri te pika 22, vazhdon me gjatësi 28.9m deri te pika 23, vazhdon me gjatësi 9.5m deri te pika 24, vazhdon me gjatësi 9.4m deri te pika 25, vazhdon me gjatësi 7.3m deri te pika 26, vazhdon me gjatësi 4.7m deri te pika 6, vazhdon me gjatësi 134.1m deri te pika 1 dhe përfundon me gjatësi 12.7m deri te pika e fillimit numër 2. Kësaj ekspertize i ka bashkangjitur gjithashtu edhe skicën e terrenit të datës 26.09.2024, si dhe certifikatën e datës 26.09.2024. fotot në ditën e incizimit të gjendjes faktike me gjykatën dhe ortofotot nëpër vite me të cilat provohet se ngastra në pjesën kontestuese nëpër vite ka qenë vresht edhe sot është vresht dhe ka pas dhe ka mexhët e vendosura faktike në teren.

Duke pasur parasysh kohën e paraqitjes së padisë dhe kohën e krijimit të marrëdhënieve juridike - civile të pretenduara nga paditësit dhe nga të paditurit - kundër paditësit si dhe periudhën kohore gjatë secilës e kanë në posedim faktik pjesën e patundshmërisë në ngastrën kadastrale në fjalë, gjykata vlerëson se në këtë çështje kontestimore, si ligj i zbatueshëm paraqitet të jetë Ligji mbi

Marrëdhëniet Themelore Juridiko Pronësore (më tutje si LMTHJP) (gazeta zyrtare e RSFJ nr.6/80) e sipas nenit 21 të LMTHJP-së, ku është e paraparë se: *“Sipas vetë ligjit e drejta e pronësisë fitohet, mes tjerash, edhe me mbajtje - parashkrim fitues...”* kurse në nenin 28 par.2 të po këtij ligji, në mënyrë decidive, thuhet se: *“Mbajtësi me mirëbesim dhe i ligjshëm i sendit të paluajtshëm, mbi të cilin tjetri ka të drejtën e pronësisë, fiton të drejtën e pronësisë mbi këtë send me parashkrimin fitues, me kalimin e kohës prej 10 viteve”*. Edhe neni 28 par. 4 parasheh se:

“Mbajtësi me mirëbesim i sendit të paluajjtshëm mbi të cilin tjetri ka të drejtën e pronësisë, fiton të drejtën e pronësisë mbi këtë send me parashkrimin fitues me kalimin e kohës prej 20 vjetësh” kurse në nenin 30 të këtij ligji, parashihet se: *“Koha e nevojshme për parashkrimin fitues fillon të ecë nga ajo ditë kur paditësi e ka marrë në posedim sendin dhe mbaron me kalimin e ditës së fundit të kohës së nevojshme për parashkrim fitues”*. Për më tepër, edhe me Ligjin e ri për Pronësisë dhe të Drejtat e Tjera Sendore, nr.03/L-154, përkatësisht me nenin 40 të tij parashihet se: *“Personi i cili me mirëbesim e ka njëzet (20) vjet në posedim të pandërprerë një paluajjtshmëri ose një pjesë të saj, e fiton pronësinë në të”*.

Pastaj, me nenin 2 par. 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), shprehimisht parashihet se: *“Në procedurë kontestimore gjykata vendos brenda kufijve të kërkesave që janë parashtruar nga palët ndërgjyqëse”*. Përfundimisht, me nenin 2 par.2 të në mënyrë decisive është paraparë se *“Gjykata i zbaton rregullat e të drejtës materiale sipas çmuarjes së saj dhe nuk është e lidhur me thëniet e palëve që kanë të bëjnë me të drejtën materiale”*, respektivisht, gjykata asnjëherë nuk është e lidhur me bazën juridike të kërkesëpadiës së paditëses, për më tepër kur dihet se kundër paditësit në kundër padinë , kanë kërkuar që e drejta e pronësisë në pjesën e patundshmërisë së ngastrës kadastrale në fjalë dhe se kjo gjykatë vendosi që kundër paditësve t’ia njoh të drejtën e pronësisë, të një pjese të ngastrës kadastrale në fjalë dhe atë mbi bazën e mirëmbajtjes me mirëbesim të saj nga paditësit.

Duke marrë parasysh të gjitha pretendimet e palëve ndërgjyqëse, provat e administruara më lartë në lidhje me këtë çështje kontestimore dhe dispozitat e lartcekura ligjore, gjykata ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditësve-të kundër paditurve është e pabazuar dhe se e njëjta duhet të refuzohet në tërësi, sikurse në dispozitivin nën I të këtij aktgjykimi. Ndërsa kërkesëpadia nga kundërpadia e të paditurve – kundër paditësve është e bazuar.

Nga provat e administruara dhe në bazë të fakteve të vërtetuara, ndërmjet palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se të njëjtit janë fqinjë në ngastrat përkatëse, konkretisht paditësit – të kundër paditurit janë bashkëpronar të regjistruar në kataster të ngastrës kadastrale me numër 349-1, ndërsa të paditurit – kundër paditësit të ngastrës kadastrale 348-1 e cila kufizohet me ngastrat kadastrale të paditësve. Kontestuese ishte fakti se paditësit – të kundër paditurit deklarorin se parcela të cilën e kishin në shfrytëzim dhe posedim të paditurit – kundër paditësit, konkretisht një pjesë e parcelës me numër P-72116046-00349-1, me shfrytëzim aktual arë e

klasës 4, në vendin e quajtur Pallanka, ZK Suharekë, me sipërfaqe prej $S=182 \text{ m}^2$, i takonte e drejta e pronësisë së tyre, që është vërtetuar edhe në bazë të certifikatës së pronës për qka të paditurit/kundër paditësit duhet ta lirojnë atë pjesë, ndërsa të paditurit – kundër paditësit përmes kundërpadisë së tyre të parashtruar pranë kësaj gjykate e kishin kundërshtuar këtë fakt, duke kërkuar nga gjykata që të i njihej e drejta e pronësisë mbi këtë pjesë të parcelës, mbi bazën e parashkrimit fitues, pasi që këtë parcelë e kishin mbjellë në kufi aktualë me vreshta që nga viti 1980.

Andaj, lidhur me këtë gjykata, sipas pikës I të dispozitivit, gjegjësisht refuzimit të kërkesëpadisë së paditësve - kundër paditurve në raport me të paditurit-kundër paditësit, gjeti se e njëjta është e pa bazuar, për faktin se paditësit kërkojnë të kthehen në gjendjen e kufijve kadastral të ngastrave kontestuese, duke u vlerësuar si kërkesë për lirim e pronës dhe për të njëjtën vlerësoi se është e pa bazuar, për faktin se të paditurit – kundër paditësit e kanë në shfrytëzim dhe posedim të pandërprerë që më shumë se 50 vite, ndërsa që nga viti 1980 e tutje e kanë mbjellë në atë kohë me vreshta, duke i vendosur shtylla betoni, si kufi faktik, ku deri në atë vend është kultivuar vreshti nga të paditurit – kundër paditësit, fakt ky i vërtetuar edhe nga vet paditësit – të kundër paditurit, të cilët gjatë seancës gjyqësore kishin deklaruar se është e vërtetë se kjo pjesë e parcelës shfrytëzohet nga të paditurit – kundër paditësit që nga vitet e 80 – ta, në kufi faktik të cilët ekzistonin në atë kohë, duke u informuar vetëm para 3-4 viteve se kjo pjesë e parcelës figuronte pjesë e parcelës së tyre. Gjithashtu, sa i përket posedimit, shfrytëzimit të pjesës së parcelës objekt kontesti nga të paditurit – kundër paditësit, ky fakt është vërtetuar edhe nga dëshmitarët e dëgjuar në seancat gjyqësore, konkretisht B, S dhe A. K, si mexhatarë të parcelës së të paditurve – kundër paditësve, të cilët kishin theksuar se kjo pronë gjithmonë është përdorur dhe punuar në kufijtë faktik, ka pasur ndarje fizike mes pronave, ku është punuar nga të paditurit – kundër paditësit, pa ndërprerë nga ajo kohë dhe agja i tyre asnjëherë nuk ka pasur ndonjë ankesë nga fqinjët, konkretisht nga familja Gashi.

Andaj, në rastin konkret gjykata ka konstatuar se në bazë të provave personale është konstatuar se të paditurit që nga viti 1980 e tutje e kanë pasur në posedim faktik të pjesës së parcelës objekt kontesti, duke mos u penguar asnjëherë nga askush, duke e shfrytëzuar në kufijtë faktik të saj.

Pra, gjykata vendosi si në dispozitivin nën II të këtij aktgjykimi, duke aprovuar kundërpadinë e të paditurve - kundër paditësve, ashtu që para se të analizojmë faktet dhe të japim vlerësimet lidhur me to, gjykata e konsideron si të nevojshme sqarimin e kushteve (elementeve) që posedon

parashkrimit fitues si bazë e ligjshme për fitimin e të drejtës së pronësisë, e të cilat duhet të plotësohen në mënyrë kumulative për të fituar dikush të drejtën e pronësisë mbi një send të paluajtshëm. Në këtë drejtim gjykata vlerëson se parashkrimi fitues në vete përmban katër elemente: (1) mbajtësi i ligjshëm, (2) mirëbesimi, (3) kalimi i periudhës kohore të caktuar me ligj dhe (4) posedimi i sendit mbi të cilin dikush tjetër e ka të drejtën e pronësisë. Posedimi i mbajtësit është “i ligjshëm” nëse mbështetet në bazën e plotfuqishme juridike që nevojitet për të fituar të drejtën e pronësisë dhe nëse nuk është fituar me forcë, me mashtrim ose me keqpërdorimin e besimit, ndërsa posedimi mund të jetë ligjor dhe pa pëlqim, por mund të jetë i paligjshëm, por me pëlqim. Më tutje posedimi konsiderohet se është me mirëbesim, po që se mbajtësi nuk e di ose nuk mund ta dijë se sendi nuk është i tij, ndërsa në raste të caktuara mirëbesimi supozohet. Në lidhje me elementin e tretë që ka të bëjë me kalimin e periudhës kohore të caktuar me ligj, gjykata fillon numërimin prej ditës në të cilën zotëruesi ka fituar të drejtën e posedimit të objekti (sendit), ndërsa në këtë periudhë mund të përfshihet edhe koha kur pala paraardhëse ka mbajtur sendin si zotërues i ligjshëm dhe me pëlqim, ndërsa periudhën kohore që duhet të kalojë për fitimin e të drejtës së pronësisë e parasheh ligji (LMTHJP apo LPDS). Elementi i katërt ka të bëjë me posedimin e sendit mbi të cilin tjetri ka të drejtën e pronësisë, por mendon se sendi është i tij dhe nuk i përket dikujt tjetër.

Në këtë drejtim gjykata vlerëson se në rastin konkret janë plotësuar katër elementet e parashkrimit fitues (të cilat i kemi cekur më lartë), pasi që të paditurit - kundër paditësit arritën të provojnë se pjesa e ngastrës kontestuese me numër 349-1, në sipërfaqe prej S=182 m², e kanë pasur (dhe e kanë) në posedim, të pandërprerë dhe me mirëbesim nga viti 1980 për më shumë se 50 vite, si dhe e ka provuar faktin se të njëjtit janë pronarë të kësaj pjese të parcelës, pasi që me të blerë këtë parcelë i kishin vendosur kufijtë faktik, konkretisht shtyllat e betonit, si dhe e kishin punuar me vreshta. Në atë ngastër janë futur pa përdorim të forcës, dhunës apo mashtrimit, e kanë punuar dhe shfrytëzuar si të tyre pa asnjë mëdyshje se po punojnë arën e huaj. Faktin se të paditurit - kundër paditësit e kanë poseduar dhe shfrytëzuar pjesën e ngastrës kontestuese (të cekur në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit) pa asnjë pengesë të vetme e kanë pohuar vetë palët ndërgjyqëse dëgjuar në këtë çështje kontestimore.

Identifikimin e kësaj pjese të parcelës, gjykata e ka bërë përmes ekspertizës së ekspertit gjeodet Adriatik Fetiu, e datës 30.09.2024, sipas së cilës ekspertizë pas daljes në teren me datë 26.09.2024, shihet se një pjesë të kësaj parcele, në sipërfaqe prej S=182 m², e shfrytëzon i padituri – kundër paditësi E. K dhe atë në anën perëndimore të parcelës, duke filluar nga pika

numër 2, me gjatësi prej 33.6m deri te pika 20, vazhdon me gjatësi 18.6m deri te pika 21, vazhdon me gjatësi 19.3m deri te pika 22, vazhdon me gjatësi 28.9m deri te pika 23, vazhdon me gjatësi 9.5m deri te pika 24, vazhdon me gjatësi 9.4m deri te pika 25, vazhdon me gjatësi 7.3m deri te pika 26, vazhdon me gjatësi 4.3m deri te pika 5, vazhdon me gjatësi 25.6 deri te pika 4, vazhdon me gjatësi 63.6m deri te pika 3 dhe përfundon me gjatësi 35.2m deri te pika e fillimit numër 2. Padiësit – të kundër paditurit M, I dhe S G, e shfrytëzojnë pjesën e parcelës me numër 349-1, me sipërfaqe prej $S=1006$ m², e cila gjendet në anën lindore të parcelës dhe fillon nga pika numër 2 me gjatësi 33.6m, deri te pika 20, vazhdon me gjatësi 18.6m deri te pika 21, vazhdon me gjatësi 19.3m deri te pika 22, vazhdon me gjatësi 28.9m deri te pika 23, vazhdon me gjatësi 9.5m deri te pika 24, vazhdon me gjatësi 9.4m deri te pika 25, vazhdon me gjatësi 7.3m deri te pika 26, vazhdon me gjatësi 4.7m deri te pika 6, vazhdon me gjatësi 134.1m deri te pika 1 dhe përfundon me gjatësi 12.7m deri te pika e fillimit numër 2.

Nga të lartcekurat dhe pas vlerësimit të provave të administruara (të cekura më lartë), gjykata erdhi në përfundim se kundërpadia e të paditurve - kundër padiësve është plotësisht e bazuar, andaj edhe vendosi që të njëjtën ta aprovojë në tërësi.

Kjo për faktin se padiësi i ka ofruar gjykatës prova të mjaftueshme me të cilat është vërtetuar fakti se i njëjti në bazë të parashkrimit fitues (mbajtjes) të paraparë me nenin 28.4 të Ligjit Marrëdhëniet Themelore Juridike - Pronësore Gazeta zyrtare nr. 6/1980 (LMTHPJ) i zbatueshëm dhe në bazë të rregullores së UNMIK-ut 1999/24, duke pasur parasysh se fillimisht paraardhësi i tij tani edhe vet padiësi ka hyrë në posedim të pjesës së ngastrës kontestuese në kohën kur ka qenë në fuqi ky ligj i cekur më lartë e kanë fituar të drejtën e pronësisë mbi ngastrën kontestuese.

Andaj, duke u bazuar në këtë gjendje të vërtetuar faktike, gjykata e ka aprovuar kërkesëpadinë e të paditurve - kundër padiësve, duke vendosur si në dispozitiv nën II të këtij aktgjykimi, konform nenit 28 par.4 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Juridike-Pronësore (LMTHJP), i zbatueshëm në kohën e krijimit të këtij raporti juridik-civil i cili përcakton se: *“Mbajtësi me mirëbesim i sendit të paluajtshëm, mbi të cilin tjetri ka të drejtën e pronësisë, fiton të drejtën e pronësisë mbi këtë send me parashkrimin fitues me kalimin e kohës prej 20 vjetësh”*.

Ndërsa nenin 30 i Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Juridike-Pronësore (LMTHJP), në paragrafin 1 dhe 2 ka paraparë se *“Koha e nevojshme për parashkrimin fitues fillon të ecë nga ajo ditë kur mbajtësi ka marrë në posedim sendin dhe mbaron me kalimin e ditës së fundit të kohës së nevojshme për parashkrimin fitues”* apo se *“Në kohën e nevojshme për parashkrimin-fitues llogaritet edhe koha për të cilën paraardhësit e mbajtësit të tanishëm kanë mbajtur sendin si mbajtës me mirëbesim dhe të ligjshëm, respektivisht si mbajtës me mirëbesim”*.

Për arsyet e njëjta të dhëna më lartë gjykata ka vendosur si në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit, dhe ka refuzuar kërkesën e paditësve M. G, I. G dhe S. G, të cilët kërkonin që të vërtetohej se të paditurit E. K dhe F. K mbajnë në shfrytëzim dhe posedim të kundërligjshëm një sipërfaqe prej 182 m² të marrë nga një ngastra 349-1 dhe ka

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 452 të LPK-së, ku gjykata ka vendosur që paditësit – të kundër paditurit M, I dhe S. G të paguajnë shpenzimet procedurale në emër të të paditurve E dhe F. K, të cilat janë 1058 euro, për të gjitha shpenzimet gjyqësore. Këto shpenzime i referohen përpilimit të kundërpadisë në shumën prej 208 euro, për mbajtjen e 3 seancave gjyqësore nga 270 euro, shumën prej 810 euro, si dhe taksa gjyqësore në shumë prej 40 euro, të cilat shpenzime duhet të paguhen brenda 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, dhe në rast se nuk paguhen, do të mund të përmbarohen me forcë.

Nga të lartëcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e konform nenit 143 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
C.nr.175/2021, dt. 13.11.2024

Gjyqtari
Robert Tunaj

Numri i lëndës: 2021:048297
Datë: 13.11.2024
Numri i dokumentit: 06449383

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi, Gjykatës së Apelit, nëpërmjet të kësaj Gjykate.